



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1126/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj, dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Artë Maliqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të KQZ, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Artë Maliqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të KQZ, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 05.12.2017, ka pranuar një apel nga Artë Maliqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22.10.2017 në Kamenicë kandidatja më e votuar nga radhët e PDK-së, ka qenë Filloreta Lakna Rexha edhe pse është e punësuar në QKMF në Kamenicë, dhe përkundër kësaj është certifikuar nga KQZ pa të drejtë ligjore. Më tej ka theksuar se në bazë të rezultateve të certifikuara nga KQZ ka qenë femra e tretë më e votuar nga radhët e PDK-së, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017. andaj ka kërkuar që të rishikohet pozita e kandidates Filloreta Lakna Rexha.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë së apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelueses gjeti se apeli i parashtruar nga Artë Maliqi kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik PDK, është i palejuar pasi që me datën 29.11.2017 KQZ në bazë të nenit 106 par.1 të LZP-së, ka bërë certifikimin e rezultateve për anëtarë të kuvendeve komunale, pas përfundimit të të gjitha

procedurave në vendvotim dhe në qendrën e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga PZAP-i dhe nga Gjykata Supreme.

Pretendimet ankimore të apelueses, që janë të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së mbi certifikimin e rezultateve në këtë rast të anëtareve të Kuvendit Komunal, është vendim i pa ankimueshëm, ne kuptim të nenit 106 par.3 të LZP-së, në të cilin parashihet se *“Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja”*. Që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për rezultate përfundimtare mund të ankimohet, por nuk mund të ankimohet vendimi për certifikim të rezultateve siç është rasti i apelit të parashtruar nga Artë Maliqi.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1126/2017 me datën 08.12.2017



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa